



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 152/1 Prot

Tiranë, më 09.02.2022

V E N D I M

Nr.18, datë 09.02.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të konkurrimit me kod #3058 dhe #3769, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve nr. 1, në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të pikës 2, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, mbi trajtimin e informacionit, për zhvillim të dy procedurave konkurimi për të njëjtin pozicion pune,

VËREJ SE:

Nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 1043 prot., datë 22.11.2021, parashtrihen disa pretendime se, gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve nr.1 në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë”, janë lejuar parregullsi, pasi janë hapur dy procedura konkurimi për të njëjtin pozicion pune (*shpallja me kod #3058 dhe ajo me kod #3769*), duke ndryshuar në mënyrë të pajustificuar kërkesat e posaçme për pozicionin e punës.

Nga këqyrja e dokumentacionit të mbledhur gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, konstatohet që, fillimisht procedura e konkurrimit për plotësimin e pozicionit “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve nr. 1 në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë”, kategoria III-b”, është shpallur me Kod # 3058 dhe është zhvilluar në tetor 2020. Në përfundim të kësaj procedure, është shpallur fitues me lëvizje paralele konkurrenti *****. Ndërkohë, ky nëpunës kishte marrë pjesë edhe në një konkurrim tjetër, për pozicionin “Inspektor” pranë

ISHMT, ku ka dalë përsëri fitues. Me shpalljen fitues në konkurrimin e dytë, ai ka paraqitur dorëheqjen nga pozicioni i mëparshëm *“Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve nr. ,1 në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë”, kategoria III-b*”, dorëheqje e cila është miratuar me urdhrin nr. 224, datë 08.10.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Metrologjisë, moment ky që shënon dhe shkëputjen e marrëdhënieve të punës me institucionin në fjalë. Aktualisht, nëpunësi *****, është emëruar nga Departamenti i Administratës Publike me aktin nr. 4607 prot., datë 05.10.2020, në pozicionin *“Inspektor në Sektorin e Inspektimit Metrologjik, në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”*.

Si pasojë, pozicioni i shpallur nga Drejtoria e Metrologjisë *“Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve nr.1 në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë”, kategoria III-b*”, ka mbetur sërish vakant ndaj, në nëntor 2021 është rihapur procedura për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, me kod **#3769**, për të njëjtin pozicion pune, e cila është përmbyllur me lëvizje paralele, me fitues konkurrentin *****.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga konkurrentja *****, se i njëjti pozicion pune është shpallur me përshkrime pune të ndryshuara në shpalljen e fundit, u bë krahasimi i përshkrimit të punës, në shpalljen me kod **#3058**, me shpalljen me kod **#3769**, nga ku rezultoi si vijon:

Përshkrim i përgjithshëm, shpallja me kod #3058	Përshkrim i përgjithshëm, shpallja me kod #3769
<ul style="list-style-type: none"> - Raporton përpara Drejtorit të Përgjithshëm ose Drejtorit të Drejtorisë për zbatimin e detyrave të ngarkuara... - Merr masa dhe siguron zbatimin e afateve dhe rregullave të caktuara.. - Në fillim të çdo muaji dhe viti paraqet punën e sektorit... - Ngarkon me detyra specialistët e sektorit - Bashkëpunon dhe përgjigjet për veprimtarinë e sektorit... për zbatimin e akteve ligjore ...si dhe veprimtarine e punonjësve në varësi - Bashkëpunon me inspektorët për problemet teknikenë fusha të ndryshme të aktivitetit - Kontrollon punën e vartësve dhe organizon analiza të punës së sektorit 	<ul style="list-style-type: none"> - Raporton përpara Drejtorit të Përgjithshëm ose Drejtorit të Drejtorisë për zbatimin e detyrave të ngarkuara... - Merr masa dhe siguron zbatimin e afateve dhe rregullave të caktuara.. - Miraton planet mujore dhe vjetore të sektorit... - Ngarkon me detyra specialistët e sektorit - Merr masa dhe organizon punën për njohjen e ligjshmërisë brenda sektorit që mbulon... - Bashkëpunon me inspektorët për problemet teknike në fusha të ndryshme të aktivitetit - Kontrollon punën e vartësve dhe organizon analiza të punës së sektorit - <i>Kontrollon plotësimin e dokumentacionit dhe veprimtarinë e secilit metrolog të sektorit, sipas planifikimit.</i>

Nga këqyrja dhe krahasimi i tyre vërehet se, detyrat e *“Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve nr. 1 në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë”* kanë të bëjnë kryesisht me natyrën organizative të punës në sektor dhe përgjithësisht, kriteret e përcaktuara janë të njëjta në të dy procedurat, me ndryshime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbin e përmbajtjes në asnjë rast.

Më tej është konstatuar që, në kërkesat e posaçme të pozicionit, ndryshimi konsiston në një shtesë që është bërë në në kriterin arsimor. Konkretisht, në shpalljen me kod **#3058**, kriteri i arsimor ishte përcaktuar *“Shkenca inxhinierike/Shkenca natyrore”*, niveli minimal i diplomës *“Master shkencor”*; ndërsa në shpalljen me kod **#3769**, në kërkesat e posaçme është shtuar edhe fusha e studimit *“Shkenca Shoqërore”*, duke e ndryshuar atë në: *“Shkenca inxhinierike/Shkenca natyrore/Shkenca shoqërore”*, niveli minimal i diplomës *“Master shkencor”*.

Ky ndryshim është bërë, pasi Departamenti i Administratës Publike, ka kërkuar saktësim të përshkrimit të punës, për ta njehsuar atë me përshkrimet për pozicionet e ngjashme në degët rajonale të institucionit, si dhe me kërkesat/kushtet e përcaktuara në ligjin e ri nr. 126/2020 *“Për Metrologjinë”*, i cili ka hyrë në fuqi në datën 15.10.2020. Për këtë arsye, pasi është bërë rishikimi i përshkrimit të punës për pozicionin në fjalë, është shtuar në fushën e arsimimit pranimit për kandidatë që kanë kryer *“Shkencat Shoqërore”*, pasqyruar kjo në shpalljen e fundit të pozicionit të punës, me kod #3769.

Në përmbledhje të sa më sipër, shtimi i kriterit arsimor, në shpalljen e konkursit për pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve nr. 1 në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë”*, është bërë që të ndikojë në mundësinë që në procesin e rekrutimit të përthithen kandidatë me cilësi më të mira, me formim më të përgjithshëm, që do të ndikojë në rritjen e cilësisë së shërbimit në sektor dhe nga ana tjetër, duke u përshtatur më mirë me kërkesat e ligjit nr. 126/2020 *“Për Metrologjinë”* dhe me kriteret që përcaktohen në pikën 2/1 (*Përshkrimi i përgjithshëm i punës për çdo kategori*), të lidhjes 3, të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, dhe pikës 4.2.10, të Udhëzimit nr. 1, datë 31.5.2017, të DAP *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*, e materializuar kjo në lidhjen 4 (*Përshkrimi i punës*).

Në këto rrethana, arrihet në përfundimin se, si njësia përgjegjëse ashtu dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, në menaxhimin e këtij rasti, pra në shpalljen për konkurrim me kod **#3058** dhe rishpalljen me kod **#3769**, për pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve nr. 1, në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë”*, kanë vepruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90 pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të konkurrimit me kod **#3058** dhe **#3769**, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve nr. 1, në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë” dhe meqënëse nuk gjenden elementë kundraligjshmërie në administrimin e këtij rasti, të bëhet arkivimi i çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe konkurrentja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha